



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 191, Datë 21.07.2022

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME VENDNDODHJE NË ZONËN BITINCKË, BILISHT, QARKU KORÇË, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37 pika 2, gërma “a”, dhe nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5 pika 1, gërma “a”, nenit 10, pikat 4, 5 dhe 6, dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.07.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1144/5 prot., datë 19.07.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me vendndodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, Qarku Korçë, me kapacitet të instaluar 2 MW”

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 87, datë 20.04.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 000 kW, në zonën Bitinckë – Bilisht, Qarku Korçë, për një afat 25-vjeçar.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE me shkresën nr. 70/10 prot., datë 22.04.2022, bëri njoftimin në media për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së

komenteve dhe objeksioneve (datë 05.05.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 450/1 prot., datë 27.04.2022, ERE njoftoi shoqërinë për vendimin e bordit nr. 87/2022, duke i evidentuar dhe dokumentacionin e munguar apo të plotësuar pjesërisht nga ky aplikim.

- Duke qenë se nuk u depozitua dokumentacion nga ana e shoqërisë, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 138, datë 06.06.2022, vendosi të refuzojë licencimin e shoqërisë “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2000 kW.
- Në të njëjtën datë, pas zhvillimit të mbledhjes së bordit, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues. Në vijim, me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 450/2 prot., datë 06.06.2022 dhe nr. 450/3 prot., datë 07.06.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues.
- ERE, me shkresën nr. 450/4 prot., datë 09.06.2022, ka njoftuar shoqërinë për vendimin e bordit nr. 138/2022, duke i dhënë asaj dhe udhëzimet përkatëse për riaplikim.
- Referuar përcaktimeve të nenit 10, pikave 5, 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, pavarësisht se parashikohet e drejta e aplikuesit për paraqitjen e një aplikimi të ri brenda 30 ditëve nga vendimi për mosfillimin e procedurës, dhe bazohet te neni 6, i cili nga ana e tij ka të bëjë me refuzimin e kërkesës për licencim, është e qartë se në këto rrethana kjo e drejtë i njihet aplikuesit dhe në rastet kur është marrë vendimi për refuzimin e kërkesës, pasi kushti thelbësor nuk është procedura në këtë rast, por afati, pra ka të bëjë me gatishmërinë e aplikuesit për t’iu përgjigjur udhëzimeve të dhëna nga ERE brenda 30 ditëve. Shoqëria e ka paraqitur dokumentacion brenda këtij afati, çka evidenton vullnetin dhe gatishmërinë e saj për të plotësuar sa kërkuar dhe sa orientuar nga ERE.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike; si dhe

lejet nga institucionet respektive. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë dokumentacionin si vijon:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” dhe “c”.
  - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”.
  - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b” “c” dhe “d”.
  - Dokumentacioni teknik për centralin fotovoltaik - neni 9, pika 4.4.1, pika 4.4.2, pika 4.4.3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d” dhe pika 4.4.4, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”.
  - Leje nga institucione të tjera - neni 9, pika 4.4.5, gërmat “a” dhe “b”.
- Në lidhje me gabimet e mundshme në referimin që i bëhet kontratave të qirave me bashkinë Devoll në akt-marrëveshjet në vijim të këtyre kontratave që shoqëria “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” sh.p.k. ka lidhur me shoqërinë “RTS” sh.p.k. dhe shoqërinë “SUN BEAT SYSTEM” sh.p.k. vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që të depozitojë në ERE informacion mbi saktësimin e gabimeve të mundshme për sa më sipër, brenda 30 ditëve pune nga marrja dijani.
- Në lidhje me kërkesën e nenit 9, pika 2, gërma “g”, vlerësohet t’i lihet kusht shoqërisë në vendimin e licencimit, që të përcjellë në ERE kontratat e qirasë të rinovuara (përkatësisht brenda datës 11.09.2018 dhe 22.11.2038) ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë.
- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, gërma “a” të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qënë se nga Studimi i Fizibilitetit të centralit fotovoltaik 2 MW rezulton se jetëgjatësia e një paneli shkon 25 – vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, Qarku Korçë, me kapacitet të instaluar 2 MW, për një afat 25-vjeçar.

2. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve pune nga marrja dijani e këtij vendimi, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion mbi saktësimin e gabimeve të mundshme në lidhje me referimin që i bëhet kontratave të qirasë me Bashkinë Devoll, në akt-marrëveshjet që shoqëria ka përcjellë në ERE.
3. Shoqëria KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” sh.p.k. duhet të përcjellë në ERE kontratat e qirasë të rinovuara (përkatësisht jo më vonë se data 11.09.2038 dhe 22.11.2038) për zonën ku do të shtrihet projekti ose çdo dokument tjetër që rregullon pronësinë.
4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.
5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**